

VENDIM
Nr.23, datë 11.1.2012

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER
PROFESIONAL”, ME KOHË TË PJESSHME, NË VITIN AKADEMIK 2011 - 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e përgjithshme e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2011-2012, të jetë 1370, e cila ndahet, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|-------|
| a) Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të pjesshme | 1230; |
| b) Kuotat për transferim studimesh | 40; |
| c) Kuota për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetas të tjerë të huaj | 60; |
| ç) Kuota për ish-të përndjekurit politikë | 40. |

2. Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të pjesshme, e përcaktuar në shkronjën “a” e pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahet sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kuota për transferim studimesh, e përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve publike të arsimit të lartë.

4. Kuota e pranimeve për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë, e përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, ndahet ndërmjet aplikantëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja. Këto kuota administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

5. Kuota e pranimeve për shtetasit e huaj që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë, e përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

6. Kuota e pranimeve për ish-të përndjekurit politikë, e përcaktuar në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, ndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë. Pranimet do të bëhen vetëm në rastet e plotësimit të kriterëve të vendosura nga institucionet publike të arsimit të lartë.

7. Çdo shtetas shqiptar që zotëron një diplomë universitare, së paku “Bachelor”, të fituar brenda ose jashtë vendit, të barasvlershme me të, ka të drejtë të aplikojë në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë.

8. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës, të përcaktuar në shkronjën “b” të pikës

1 të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me kriteret e përcaktuara e të bëra publike paraprakisht.

9. Tarifat e shkollimit dhe tarifat e shkollimit për çdo kredit, për aplikantët që do të regjistrohen në vitin e parë, në programe të para studimi të ciklit të dytë, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2011-2012, të jenë, për çdo program studimi dhe institucion publik të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në tabelën nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi.

10. Kandidatët që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012, dhe që u përkasin shtresave sociale, si: personat që nuk shikojnë dhe që nuk dëgjojnë, invalidët, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, paraplegjikët dhe tetraplegjikët, fëmijët që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijët e policëve dhe ushtarakëve të rënë për shkak të detyrës dhe të ish-të përndjekurve politikë paguajnë një kuotë në masën 50% të tarifës së shkollimit. Këtë të drejtë do ta kenë edhe studentët e viteve më të larta, që u përkasin po këtyre shtresave sociale.

11. Studentët e paguajnë tarifën e shkollimit, të ndarë në këste, në përputhje me kreditet e lëndëve që do të frekuentojnë në çdo vit akademik. Studenti i nënshtrohet tarifës së shkollimit për një lëndë sa herë e frekuenton atë.

12. Studentët e shkëlqyer përjashtohen nga tarifa e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

13. Shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet në një program studimi, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare, shtetërore, është parashikuar ndryshe.

14. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha